

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti I përgjithshëm- me Gjyqtaren Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit E.(A.) Rr. nga fsh....Bajram Curr, R. e Shqiperise. sipas Aktakuzës të PTH-DP në Gjakovë, PP.nr.1578/2018 të datës 05.11.2018 për shkak të veprës penale,posedim i pa autorizuar i narkotikëve,substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me propozimin për dhënien e urdhër ndëshkimor me datën **10.01.2019**, morri këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP në Gjakovë, PP.nr. 1578/2018 të datës 05.11.2018 dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

E.RR. , nga i ati A. dhe e ëma F. e gjinisë B., data e lindjes ... në T., e tani me banim në fsh. fsh....Bajram Curr, R. e Shqiperise, me nr. personal ID- 0....., student, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Shqiperise. dhe më parë i padënuar.

Ë s h t ë f a j t o r :

Për shkak se me datën 15.10.2018 rreth orës 15.00,në pikën kufitare në Q.P.,në hyrje të Rep.së Kosovës,pa autorizim posedon substancë narkotike psikotrope apo analoge,të pa lejuar dhe të rrezikshme, në atë mënyrë që ditën kritike, pas ndalimit të automjetit "T...",ngjyrë të gjelbër,me targa ... të cilën e drejtonte i pandehuri E.gjatë kontrollit rutinor nga ana e zyrtarëve Policorë kufitarë, tek ndërruesi i shpejtësisë i është gjetur një cigare "J.."e mbushur me substancë në formë bari,e llojit Marihuanë si dhe në derën e shoferit po ashtu i është gjetur edhe një cigare "J..."e mbushur me substancë në formë bari, në përbërje kimike të përmbajtjes "**Canabis (Mariuhanë)**"që përmbante Tetrahidrokanabinol (THCH),në peshë të përgjithshme prej:1.61+-0.001 gram.

- me çka ka kryer veprën penale,posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata komfor nenit 4,41,43,46,73 dhe nenit 275 par.2 të KPRK-së, dhe nenit 495 të KPPK-së, të akuzuarit,

I S H Q I P T O N

Dënim me gjobë në shumën prej **200.-(dyqind).-€**, të cilën dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësojë me dënim burgu në kohëzgjatje prej **10(dhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I SHQIPTOHËT: dënimi plotësues konfiskohet substanca narkotike e llojit “**JOINT**” e mbushur me substancë në formë bari, në përbërje kimike të përmbajtjes “**Canabis (Mariuhanë)**” që përmbante Tetrahidrokanabinol (THCH), në peshë të përgjithshme prej: 1.61+-0.001 gram dhe e njëjta duhet të asgjësohet, këtë konform nenit 62 par.1 dhe 2 nën paragrafi, 2.6 lidhura me nenin 69 të KPRK-së

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore-Departamenti i përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritur Aktakuzë PP.nr.1578/2018 të datës 05.11.2018, kundër të akuzuarit E.R. nga fshati fsh....Bajram Curr, R. e Shqiperise, për shkak të veprës penale, posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.2 të KPRK-ës, me propozim që ndaj të akuzuarit ti jepet urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-së gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-së dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranojë kërkesën e PTH-DP në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe ti shqiptojë ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palën e pa udhëzuar është e nevojshme që ti referohet dispozitës së nenit 275 par 2 e cila dispozitë për kryesin e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë në 1(një) vit.

Gjykata vlerëson se provat që janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

-Raporti fillestar i incidentit me nr. rasti 2018-DHTN-YWP-007 të dt. 15.10.2018.

-Raporti i oficerit I. Gj. #6137.

-Vërtetime mbi sekuestrimet e përkohshme të sendeve dhe substancave narkotike nga polici K. me nr.K.I710 dhe U.M. me nr.K.I 7712 i dt. 15.10.2018.

-Raporti i ekspertimit i dt. 19.10.2018.

-Foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë, vërtetohet se i akuzuari E.Rr. ka kryer veprimet e përshkruara si në bazën faktike të kësaj aktakuze.

Gjykata, këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-ës, në mënyrë që të parandalohet kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhërin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
-Departamenti i përgjithshëm-
P. nr.787/18 më datë 10.01.2019

Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja,
Diana Sina

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi i akuzuari dhe mbrojtësi i tij mund të ushtrojnë Kundërshtim, në afat prej **8** ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtarit të kësaj Gjykate. Nëse i pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.